



KRITERET

**PËR VLERËSIMIN E RËNDËSISË DHE LIDHJES SË
PËR PJEKJEVE NGA PROCESI I BASHKË-KRIJIMIT TË PLANIT
AKSIONAL PËR PARTNERITET TË QEVERISJES SË HAPUR
ME PARIMET E PARTNERITETIT TË QEVERISJES SË HAPUR**

Shkup, Tetor, 2020



Në Partneritetin e Qeverisjes së Hapur, qeveritë dhe shoqëria civile së bashku krijojnë plane aksionale dy-vjeçare me hapa konkretë - përpjekje - në lidhje me reformat të cilat qeveritë janë të obliguara ti zbatojnë.

Një nga bazat e «Partneritetit të Qeverisjes së Hapur» është përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në zhvillimin e planit aksional. Në fakt, një nga qëllimet e këtij partneriteti është pëforcimi i marrëdhënieve midis organizatave të shoqërisë civile, shoqërisë dhe qeverisë.

Prandaj, përpjekjet zhvillohen përmes një procesi të konsultimit, me shumë palë të interesuara në të cilin qeveria përfshin në mënyrë aktive organizatat e shoqërisë civile.

Ç’do përpjekje duhet të jep një përshkrim të gjendjes aktuale status quo për të përshkruar / shpjeguar problemin që duhet të zgjidhet, të përcaktohet qartë se si do të kontribuojë në tejkalimin e gjendjes aktuale, për një transparencë më të madhe, llogaridhënie dhe / ose përfshirje të qytetarëve; kush do të përfshihet në zbatimin e përpjekjeje dhe atë që autoritetet shpresojnë të arrijnë duke ndërmarrë atë përpjekje. Gjithashtu përpjekjet duhet të përfshijnë treguesin kryesorë, të matshëm dhe një kornizë kohore për zbatim.

Struktura e planit aksional:



Temat /
Fushat prioritar



PËRPPJEKJE



Arritjet /
Hapat /
aktivitete

- ✓ Konkrete
- ✓ Relevante për vlerat e PQH-së:
 - Qasja në informata
 - Pjesëmarrja civile
 - Llogaridhënie publike
 - Teknologjitë dhe inovacioni për transparencën dhe llogaridhënien
- ✓ Potenciali për ndiki
- ✓ Për të hapur Qeverinë
- ✓ Te janë të lidhur me Qëllimet Globale të KB-ve për zhvillim të qëndrueshëm



Kriteret për krijimin e përpjekjeve për Partneritetin e qeverisjes së hapur¹

Specifikimi: Përpjekja duhet të tregojë qartë ç'farë është ajo që qeveria përpiqet të arrijë duke përshkruar aktivitete konkrete që do të ndërmerren për të arritur qëllimet e qeverisë së hapur të vendit.

Matshmëria: Çdo përpjekje duhet të përcaktohet nga qëllime dhe arritje të matshme, të nevojshme për të monitoruar progresin e zbatimit të përpjekjes. Matshmëria duhet të hartohet ashtu që të mundësojë evaulimin e rezultateve të përpjekjeve të cilat dalin nga përpjekjet.

Tendenca për të ndërmarrë veprim: Përpjekjet duhet të argumentojnë se si do të arrihen rezultatet dhe qëllimet e Partneritetit të Qeverisjes së Hapur. Përpjekjet duhet të përfshijnë shpjegime të shkurtra të aktiviteteve, metodologjive, mjeteve dhe proceseve që do të përdoren nga autoritetet për të arritur qëllimet.

¹ Partneriteti i Qeverisë së Hapur, "Përgatitja e Planit". Mundësuar në: <https://www.opengovpartnership.org/civil-society-engagement/prengt-the-plan/> (vizituar për herë të fundit: 18.09.2020)

Relevanca: Përpjekjet patjetër duhet të adresojnë çështje që lidhen me transparencën e qeverisë, sesa reformat më të gjera të qeverisë. Aspektet kryesore të një partneriteti të qeverisjes së hapur përfshijnë: transparencën e informacionit, pjesëmarrjen publike dhe civile dhe llogaridhënien, dhe përdorimin e teknologjisë dhe zgjidhjeve inovative. Prandaj, formulimi i përpjekjeve duhet të pasqyrojë këto parime.

Prandaj, një përpjekje e duhur brenda Partneritetit të Qeverisjes së Hapur është një aktivitet që nuk ka përbajtjen në detyrimet ekzistuese ligjore të institucioneve ose në politikat dhe strategjitë e tjera. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë që qëllimi i përpjekjeve përfundon me transparencën e qeverisë. Përkundrazi, përpjekja e mirë e shfrytëzon procesin e transparencës së qeverisjes për të kontribuar në zgjidhjen e problemeve më të gjera shoqërore. Një shembull i ndryshimeve më të gjerë shoqërore është pëmbushja e qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, përkatësisht qëllimet prioritare të Maqedonisë së Veriut.

Afati kohor: Përpjekjet duhet të kenë afate saktë të përcaktuara për realizimin e tyre me qëllim të nxitjes të ndërmarrjes së aktiviteteve. Secila përpjekje duhet të ketë afate të caktuar përmes të cilave mund të demonstron progresi i zbatimit.



Lista e vlerësimit të evaluimit të përpjekjes

Numri rendor	Kriteret	Numri i pikëve
1	Specifikimi	
1.1	Përpjekja është zhvilluar në nivelin e aktiviteteve konkrete	1
1.2	Për përpjekjen ekziston një institucion specifik përgjegjës për përbushjen e tij	1
1.3	Për secilin aktivitet të përpjekjes ekziston një institucion specifik përgjegjës për përbushjen e saj	1
1.4	Përpjekja jep një përshkrim të qartë të situatës aktuale	1
1.5	Përpjekja përshkruan problemin që duhet zgjidhur	1
1.6	Qëllimi dhe rezultatet e pritura nga përpjekja janë përcaktuar	1
1.7	Zbatimi i përpjekjes do të kontribuojë në tejkalimin e situatës aktuale	1
2	Matshmëria	
2.1	Ekziston një mënyrë e caktuar për përpjekjen për të përcaktuar përfitimin që shkakton në arritjen e qëllimeve më të gjera	2
2.2	Për secilin aktivitet do të jetë e mundur të përcaktohet nëse ka filluar apo përfunduar	1
2.3	Për secilin aktivitet ekziston një mënyrë e caktuar se si do të përcaktohet gjendja e përbushjes së saj	1
2.4	Ka vlerësim relativisht të saktë se sa do të kushtojë përpjekja	1
3	Tendenca për të ndërmarrë veprim	
3.1	Përshkrimi i përpjekjes përmban një shpjegim se si aktivitetet do të çojnë në realizimin e përpjekjes	1
3.2	Përshkrimi i përpjekjes përmban një shpjegim se si përpjekja do të çojë deri në arritjen e objektivave të PQH-së	1
3.3	Për të gjitha aktivitetet ka përshkrim i shkurtër	1

Numri rendor	Kriteret	Numri i pikëve
4	Relevanca	
4.1	PËrppjekja është e re, dmth nuk është vazhdim i pËrppjekjes së mëparshme	1
4.2	Zbatimi i pËrppjekjes do të përmirësojë transparencën e qeverisë	2
4.3	Zbatimi i pËrppjekjes do të rrisë llogaridhënine e qeverisë	2
4.4	Zbatimi i pËrppjekjes do të rrisë pjesëmarrjen e qytetarëve	2
4.5	Një proces i ri teknologjik do të zbatohet për të përbushur pËrppjekjen	2
4.6	PËrppjekja nuk është pjesë e obligimeve të rregullta të institucioneve	2
4.7	PËrppjekja nuk është pjesë e planeve aksionale të veprimit në dokumentet e tjera strategjike të pushtetit	2
4.8	PËrppjekja është në temë që lidhet me qëllimet ekzistuese strategjike të pushtetit	2
4.9	PËrppjekja është në temë që lidhet me qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit	2
5	Afati kohor	
5.1	PËrppjekja ka caktuar saktë afatet me datën fillestare dhe përfundimtare të realizimit	1
5.2	Për secilin aktivitet kanë afate saktë të caktuara	1

Çdo nën-kriter në listë për të kontrolluar evaulimin e pËrppjekjes vlerësohet me numrin e përcaktuar të pikëve në listë, dmth. pikët e parashikuara jepen nëse plotësohet nën-kriteriumi, ose nuk jepen pikë nëse nuk plotësohet nën-kriteriumi.

Kushtet për mospranimin e pËrppjekjes janë nësej:

- ▲ pËrppjekja nuk përbush minimumin 23 pikëve ose
- ▲ nën-kriteret 4.5 dhe 4.6 nuk plotësohen bashkarisht.



Vlerësimi i përpjekjeve pas definimit kriterëve për krijimin e përpjekjeve

Gjatë takimeve konsultative, moderatori e drejton punën në drejtim të përmbushjes së **kriterit të rëndësisë** dhe nën-kritereve përkatëse, dmth moderatori i jep përparësi problemeve dhe propozim zgjidhjeve që plotësojnë më së miri kriterin e rëndësisë.

Pasi të janë bërë përpjekje të plota dhe t'i dorëzohen Këshillit, anëtarët e Këshillit individualisht vlerësojnë përpjekjet sipas të gjitha kriterëve nga lista për të kontrolluar evaulimin e përpjekjes. Kështu, nëse moderatori i grupit të punës është gjithashtu anëtar i Këshillit, në atë rast nuk vlerëson përpjekjet që kanë rezultuar nga puna e atij grupi punues.

Nota e përgjithshme sipas përpjekjes është rezultati mesatar i të gjitha notave totale individuale të anëtarëve të Këshillit që kryen vlerësimin.

Bashkëngjitur këtij dokumenti është një bazë për llogaritjen e pikëve për përpjekje sipas kriterëve të përcaktuara, të cilat do të përdoren nga anëtarët e Këshillit.



"Kriteret për vlerësimin e rëndësisë dhe lidhshmërisë së përpjekjeve të procesit të bashkë-krijimit të një Plani Aksional të Partneritetit të Qeverisjes së Hapur me parimet e Partneritetit të Qeverisjes së Hapur" u përgatitën nga nëngrupi i punës i themeluar në kuadër të Këshillit të Koordinimit dhe Përcjelljen e procesit të PQH-së dhe Plani Nacional Aksional për Partneritet të qeverisjes së hapur 2018 - 2020, i përbërë nga: Gordana Gapiq Dimitrovska, Misha Popović , Martin Todevski, German Fillkov dhe Darko Antiq.

